



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 380/2024
Datë: 31/10/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-227 për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore, Ndërmjetësim dhe Arbitrazh, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Fitore Gajtani, avokate shtetërore në Avokaturën Shtetërore, caktohet ushtrues detyre e Zëvendës Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror në Avokaturën Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ushtruesja e detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi është gjashtë (6) muaj dhe fillon nga datë 01.11.2024.
4. Obligohet Avokatura Shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Fitore Gajtani;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Avokaturës Shtetërore;
- Arkivit e Ministrisë së Drejtësisë.